



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA

VENDIM

Nr 3 , Datë 23. 11. 2012

Për

Miratimin e projekt-idesë “Projekti i Digës H/C Ura e Fangut mbi lumin Fan i Madh”

Në zbatim të pikës dh, neni 4, kreu II, të ligjit nr.8681, datë 02.11.2000 “Për projektimin, ndërtimin, shfrytëzimin, dhe mirëmbajtjen e digave dhe dambave”, neni 8, 13, të “Rregullores për sigurinë e digave dhe dambave”, Komiteti Kombëtar i Digave të Mëdha (KKDM) dhe Këshilli Teknik i Përhershëm i Digave (KTPD), në mbledhjen e tij të datës 12.11.2012, mori në shqyrtim projekt-idenë “Për ndërtimin e Digës së Hydrocentralit të Urës së Fanit”, i hartuar nga firma projektuese “AYEN AS ENERGJI”. Projekt-ideja u paraqit nga firma projektuese “AYEN AS ENERGJI”, në Këshillin Teknik të Përhershëm të Digave dhe Komitetin Kombëtar të Digave të Mëdha.

Komiteti Kombëtar i Digave të Mëdha pasi dëgjoi referimin e grupit të projektimit për digën dhe nënobjektet, bazuar edhe në raportin e Këshillit Teknik diskutoi projekt-idenë dhe :

Vendosi:

Të miratojë në parim projekt-idenë për Digën e Fangut si digë e klasit të parë e tipit me gurë, ekran të papërshkueshëm beton-armeje dhe perde çimentimi. Hartuar në mbështetje të VKM nr. 365, datë 04.05.2011, duke kërkuar si më poshtë:

1. Materiali në dosje duhet të plotësohet me një kapitull ku të sqarohen kriteret e projektimit dhe standartet mbi të cilat është mbështetur projekti i digës dhe nën objekteve të saj.

2. Pranimi i prurjes së projektit për shkarkuesin me përsëritje një herë në dhjetëmijë vjet është në përputhje me Kushtin Teknik Shqiptar, ndërsaq në kërkojmë që të argumentohet më mirë kjo mbështetur edhe në rekomandimet e ICOLD-it. Mendojmë se analiza bazuar në ANCOLD do të jetë një argument i plotë për vlerësimin e sigurisë së digës, pra të përcaktohen prurjet e projektit dhe prurja e sigurisë dhe Frankoja e plotë, siguria në përputhje me kërkesat e këtij dokumenti.
3. Kërkojmë që projekti të shoqërohet me materialin e plotë hidrologjik, për të parë e gjykuar lidhur me prurjet maksimale, dhe prurjen e ngurt, për objektin.
4. Do të sugjeronim që kuota e nivelit të vdekur në rezervuar të ngrihet, për të realizuar një volum të mjaftueshëm lidhur me afatin e parashikuar për funksionimin e kësaj vepre. Mendojme se volumi prej 4 milion m³ nuk mjafton ose kërkon argumente të tjera lidhur me prurjen e ngurtë.
5. Perdja e çimentimit është trajtuar në mënyrë të përgjithshme dhe nuk ka një projekt-ide me argumentat e mjaftueshëm, mendojmë të plotësohet.
6. Shkarkuesi fundor komandohet nga një valvol e vetme e vëndosur në dalje të tunelit, vlerësojmë se një zgjidhje e tillë është e pasigurt, po të kemi parasysh që ky shkarkues do të shërbejë edhe për shpëlarjen e aluvioneve. Të propozohet një zgjidhje tjetër.
7. Për studimin sizmologjik, realizuar nga Inst. Gjeoshkencave Gusht 2011 dhe për analizat e kryera nga firma projektuese "AYEN AS ENERGJI" sipas relacionit dhe prezantimit, në studim të jepen karakteristikat sizmologjike të zonës së ndërtimit, lidhur me shpejtimin sizmik:

Së pari, ato janë shprehur në kufij të gjërë (p.sh në konkluzione, pika 5, fq.21-22 si shpejtim max i truallit jepet PGA: 0.1-0.15g), pra nuk jepen të preçizuara.

Së dyti, thuhet që zona përfshihet e klasifikuar në intensitet maksimal të pritshëm VII (ballë -MSK- 64), me probabilitet 75% në 100 vjet (pika 4, Konkluzionet).

Të dyja këto konkluzione mendojmë se janë krejt të pamjaftueshme, veçanërisht për projektimin e digës 81m të lartë të HEC-it të Fangut, sepse nuk ka vlerë preçize shpejtimi dhe probabiliteti i referuar 75% në 100 vjet (pika 4), është shumë i madh.

- Ndërkaq, gjatë prezantimit që ju bë projektit në Komitetin Kombëtar të Digave të Mëdha në datë 12.11.2012, nga ana e grupit projektues u tha: që llogaritjet e digës janë bërë me akseleracion projektues 0.24g, duke e dhënë këtë vlerë si "gjysma e akseleracionit maksimal të mundshëm në zonën e ndërtimit: 0.48g" dhe duke shtuar se "ky akseleracion është më i madh se ai që mund të ndodhë". Por, lidhur me vlerën PGA= 0.48g në relacionin e projektit nuk jepen argumente se si ka dalë kjo vlerë, mbi ç'bazë studimi mikrozonimi sizmik dhe mbi bazën e cilës rregullore

apo standart, konsiderohet e pranueshme llogaritja e digës me gjysmën e vlerës maksimale të PGA.

Vërejmë se një tërmet jo shumë i hershëm dhe jo shumë larg digës së Fangut, që është tërmeti i Malit të Zi i vitit 1979, e ka pasur PGA (max) rreth 0.45g.

- Për projektin (analiza sizmike e digës) krahas vërejtieve të mësipërme mbi PGA llogaritëse në princip vihet re edhe vlerësimi jo i mjaftueshëm i analizës sizmike të digës së Fangut. Konkretisht përdorimi i metodës pseudo-statike, që vëren edhe reënca mund të jetë i pranueshëm për fazën e projektit-idesë, por i pamjaftueshëm për fazën e projektit të zbatimit.

Prandaj mendojmë që së pari, duhet përgatitur një raport sizmologjik mjaft më i plotë dhe i specifikuar për zonën e ndërtimit të digës së Fangut që do të shërbejë për të dyja fazat, projekt-ide dhe projekt-zbatimi ku të përcaktohen nxitimet në truall (PGA) për raste tërmetesh të rrallë, konform rëndësisë së digës, me probabilitet të vogël, konform standarteve të sotme dhe rekomandimeve që jep ICOLD-i (Komiteti Ndërkombëtar i Digave të Mëdha). Pra diga të analizohet si për një tërmet të punës apo funksionalitetit (Operating Bazis Earthquake-OBE), ashtu edhe për një tërmet shumë të fortë dhe të rrallë, tërmetin e projektimit (Maximal Design Earthquake – MDE). Mbi këtë bazë, më tej të kryhen analizat sizmike, pseudo-statike **për projekt-idenë**. Më tej, analizat duhen të bëhen të plota, dinamike, për projektin e fazës tjetër (projekt-zbatimit), me futjen si “input” të akselerogramave të përshtatëshme dhe të argumentuara duke patur si amplitude maksimale ato që dalin si PGA nga studimet sizmologjike përkatëse (pa i reduktuar), por duke konsideruar edhe kapacitetet shuarse dhe absorbuese (shuarse) të energjisë. Analizat t'i referohen tërësisë së digës si dhe qëndrueshmërisë së skarpave apo zonave e pjesëve të veçanta, prej ku të dalin edhe koficientët përkatës së sigurisë, si për fazën e projekt-idesë ashtu edhe për projektin në vazhdim (projekt-zbatimin) dhe këto të krahasohen me kriteret.

- Edhe objekteve të rëndësishme të nyjeve hidraulike në këto HEC-e, në veçanti pritrat (digat e ulta), por edhe objekte të tjera (ndërtesat e centralit etj) duhet të analizohen dhe projektohen mbi bazën e kërkesave bashkëkohore europiane ose botërore, bazuar sidomos në “tërmetin e projektimit” përkatës dhe konform rëndësisë së tyre.
- Të dalin më qartë natyra dhe karakteristikat (veçoritë) e programeve (software-ve) SLIDE 6 (p.sh) që janë përmendur për analizat konstruktive, statike dhe sizmike të objekteve të ndryshme (diga, ndërtesa centrali) etj.

Të plotësohen kërkesat e mësipërme brenda një afati kohor sa më të shkurtër që të merret miratimi i plotë i projekt-idesë nga Komiteti Kombëtar i Digave të Mëdha.

Me respekt,

Peri **DISHNICA**

KRYETAR